

Data 10.11.2025

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje karburant i ndarë në dy lote si më poshtë:

LOTI 1: “Blerje gazoil 10 PPM”.

LOTI 2: “Blerje benzine pa plumb per automjete, gjenerator dhe pajisje korrse bari”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
09134100-8;

VLERA E FONDIT LIMIT: 7,436,000 (shtatë milion e katërqind e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh;

Loti 1: Blerje gazoil 10 PPM” me fond limit 7,150,000 (shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa tvsh;

Loti 2: “Blerje benzine pa plumb per automjete, gjenerator dhe pajisje korrse bari” me fond limit 286,000 (dyqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT JANË TË NJËJTA PËR TË DYJA LOTET

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Albanian Gas Service Company Sh.A.

Rruga “Kosovareve”, pallati NderPro Sh.P., Tirana, Albania

NUIS: L82407006D

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të lotit përkatës, apo shumatores së fondit limit të të dy loteve për të cilat oferton.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto tre vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit limit të lotit përkatës apo shumatores së fondit limit të të dy loteve për të cilat oferton.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e realizuara. ose
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe mallrat e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe neneve 40, 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën

jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20% të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “tregues kryesor”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë EN ISO 9001-2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalent).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e karburanteve pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë /raport analizë për gazoil 10 ppm sipas standartit EN 590:2022 ose ekuivalente, dhe për benzinën SSH EN 228:2012+A1:2017 ose ekuivalente të lëshuar nga një laborator i çertifikuar në Republikën e Shqipërisë. Fletë/raport analiza duhet të jetë lëshuar jo më parë se 3 muaj nga data e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në nenet 40, 55 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në nenin 23 “Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre”, në piken 2/a/v, të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, si dhe në VKM Nr. 410, datë 13.5.2015 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit shtetëror teknik dhe industrial”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se ofrojnë produktin sipas standarteve ligjore. Fletë/raport analiza do të shërbejë AK për të krahasuar rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucioni i autorizuar, që vërteton pajtueshmërinë e karburantit që furnizon operatori ekonomik pjesëmarrës në tender në standartin shqiptar (SSH) 590:2013+A1:2017 ose ekuivalente të adoptuar nga DPS të kërkuara në DT.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon kapacitet teknike dhe merrë përsipër të plotësojë të gjitha kërkesat si më poshtë:

- i. Operatori ekonomik ofron furnizimin me karburant 24 orë në 24 orë në të gjitha pikat e shitjes në rrethet e kërkuara Tiranë, Korçë, Fier, Berat dhe Skrapar me **pistoletë publike**, me karte elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti ose gjeneratorët e levizshëm, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- ii. Operatori ekonomik merr përsipër të ofrojë karta elektronike për të gjitha mjetet, gjeneratorët e levizshëm dhe pajisjet e korjes së barit që autoriteti kontraktor disponon, deri në përfundimin e plotë të kontratës, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor. Kartat elektronike duhet të jenë pa skadencë dhe të përdorshme për të gjithë periudhën deri në përfundim të të gjitha sasive të litrave.
- iii. Operatori ekonomik disponon një faqe menaxhimi të karburanteve (ëebpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për mjetet efektive të transportit të kryhet nepermjet kartës elektronike.
- iv. Operatori ekonomik disponon pika të shitjes së karburantit me pakicë në rrethin e Tiranës, Fierit, Korçës, Beratit, si dhe Skrapar të vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë qiraje, përdorimi noteriale ose akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e regjistrimit tregtar të lëshuar nga QK, etj).

Kriteri do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, Shtojca nr. 9 në DT. Dokumentat e kërkuara do të paraqiten përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, nga ofertuesi i kualifikuar i pari.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si edhe referuar Ligjit Nr.8450 dt.24.02.1999 “Për përpunimin, transportin dhe tregtimin të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, me ndryshimet.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (ky kod është i publikuar në SPE së bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së

Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut të lire, parime këto të përcaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoret e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t'i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t'i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SHA që kanë lidhje me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar bazuar në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 40/3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në standardin EN 590:2022 dhe SSH EN 228:2012+A1:2017 por lejohet dhe paraqitja e ekuivalenteve të tyre.